

Kushtet e Përgjithshme të Sigurimit në Grup të Punonjësve nga Aksidentet Personale

I. Objekti i mbulimit me Sigurim

Në përputhje me parashikimet e kushteve të përgjithshme dhe Tabelës së Përfitimeve-pjesë e kontratës si edhe përcaktimëve në policën e sigurimit, shoqëria e sigurimeve SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a, me seli qëndrore në adresën ‘Blv. Zog I’, Nr.1 Tiranë (këtu më poshtë do të quhet ‘Siguruesi’) do të paguajë përfitim për shkak të paaftësisë apo humbjes së jetës të personit të siguruar të specifikuar në policën e sigurimit që mund të rezultojë si pasojë e një aksidenti dhe shpenzimet e trajtimit mjekësor që bëhet i domosdoshem per shkak të aksidentit të ndodhur gjate periudhës së sigurimit të treguar në policë, dhe për të cilën ky sigurim është i vlefshëm, gjatë ushtrimit të:

- a. Veprimtarisë profesionale të treguar në Policën e Sigurimit;
- b. Të veprimtarive që nuk kanë karakter profesional

II. PËRKUFIZIME

‘I Siguruar’ - nënkupton Individu(ët) e emërtuar si të Siguruar në Listën e të Siguruarve ose në ndryshime të mëvonshme të saj, të moshës deri në 65 (gjashtëdhjetë e pësë) vjeç në datën e fillimit të Policës. Të Siguruarit që arrijnë këtë moshë gjatë periudhës së sigurimit, do të mbulohen deri në përfundim të kësaj periudhe.

‘Policëmbajtës/ Kontraktues’ - Punëdhënësi i përcaktuar si Kontraktues në Formularin e Policës.

‘Aksident’ – Përcaktohet çdo ngjarje e papritur dhe e paparashikuar që ndodh në mënyrë rastësore pa vullnetin e të Siguruarit, e identifikuveshme për sa i përket kohës dhe vendit të ndodhjes, që ka impakt trupor të drejtpërdrejtë, të jashtëm dhe të dhunshëm mbi të Siguruarin dhe që sjell si rrjedhojë humbjen e jetës, paaftësinë për punë ose dëmtime trupore të të Siguruarit.

Do të konsiderohen aksidente edhe :

(i) *Helmimi akut i pavullnetshëm ose djegie të pavullnetshme që vijnë si shkak i gëlltijes ose rënies në kontakt me substancë tokiske ose gërryese dhe gazrave apo avujve tokikë, përveç sëmundjeve profesionale; (ii) Goditja elektrike (ku përfshihet edhe goditja nga rrufeja); Asfiksia, Mbytja, ngrirja, goditja e diellit përfshirë plagët e shkaktuara nga rrezet ultraviolet por jo djegia nga dielli; (iii) Shkëputja ose ndrydhja muskulare që vijnë si shkak i sforsimit fizik; (iv) Trazirat civile masive apo aktet terroriste, me kusht që i Siguruarit të mos ketë marrë pjesë aktive në to; (v) Rastet e infeksioneve të shkaktuara nga plagët e një aksidenti, si edhe infeksionet nga tetanozi apo tèrbimi; (vi) Rëniet nga lartësitë.*

‘Dëmtim Trupor nga Aksidenti’ – Dëmtim trupor që pëson i Siguruarit brenda periudhës së Policës, që shkaktohet vetëm dhe drejtpërdrejt nga një Aksident (duke përjashtuar sëmundjet ose çrrëgullimet shëndetësore) dhe që sjell si rrjedhojë humbjen e jetës ose paaftësinë për punë të të Siguruarit brenda 12 muajve kalendarikë nga data e Aksidentit.

‘Paaftësi e plotë e përherershme’ paaftësia që e ndalon plotësisht të Siguruarin për të ushtruar profesionale/punësimë për të cilat është i aftë nga arsimimi, trainimi ose përvoja, dhe që zgjat të paktën 12 muaj të pandërprerë dhe në fund të kësaj periudhe është pa shpresë përmirësimi.

‘Policë sigurimi’- nënkupton kontratën e sigurimit, kushtet e kontratës, Formulari e sigurimit dhe çdo shtojcë ose ndryshim i mëvonshëm i nënshkruar nga Siguruesi

‘Përfitim’ – shuma përkatëse e sigurimit ose pjesë të saj siç përcaktohet në Formularin e Policës, shtojcave të saj dhe në Tabelën e Përfitimeve pjese përberëse e kontratës sigurimit, e pagueshme nga Siguruesi në përputhje me kushtet dhe parashikimet e kësaj Police për çdo ngjarje ose dëmtim që mbulohet nga kjo Policë.

“Subrogimi ose e drejta e zëvendësimit” nënkupton se i siguruarit e zëvendëson (kalon) të drejtën e tij, për të kërkuar dëmshpërblim nga personi përgjegjës për dëmin (shkaktari), me te drejtën për tu dëmshpërblyer, apo për tu kompensuar, nga SIGAL UNIQA. Kjo do të thotë se i Siguruarit, i kalon të drejtën ligjore SIGAL UNIQA, për të kërkuar dhe arkëtuar vlerën e demit te paguar nga një palë e tretë, që është pala dëmtuese apo përgjegjëse.

Sigurimi në Grup i Punonjësve nga Aksidentet Personale

“Rrjeti Mjekësor i Siguruesit” përfshin spitalet, qendrat mjekësore, farmacitë, ambulancat, mjekët apo specialistët e certifikuar që kanë një marrëveshje me Siguruesin dhe që janë zgjedhur nga ai për t'i dhënë të Siguruarve, shërbime mjekësore.

III. PËRJASHTIME TË MBULIMIT NË SIGURIM

Siguruesi nuk do të mbulojë humbjen e jetës, paaftësinë për punë apo dëmtime trupore të të Siguruarit që janë rrjedhojë direkte ose indirekte e:

- a. luftës, pushtimit, veprimeve të armikut të jashtëm, armiqësive/luftimeve (pavarësisht nëse është shpallur luftë ose jo), luftës civile, rebelimit, revolucionit, revoltës, kryengritjes ose masat për qetësimin e tyre;
- b. përmbytjes, zhvendosjes së tokës, shpërthimeve vullkanike, tërmeti, katastrofave natyrore;
- c. qëndrimit në zona klimaterike të rrezikshme ose pjesëmarrjes në ekspedita për qëllime shkencore ose për qëllime të tjera;
- d. praktikimit nga ana e të Siguruarit të veprimtarive profesionale sportive (gara apo stërvitore) të cilat nuk janë deklaruar si profesione;
- e. pjesëmarrjes së të Siguruarit në gara apo konkurime sportive të mjetit motorik apo lundrues, qoftë drejtues, pjesëtar i ekuipazhit apo pasagjer;
- f. përdorimit të një mjeti fluturimi me ose pa motor, qoftë drejtues apo anëtar i ekuipazhit të tij;
- g. të gjitha llojeve të sëmundjeve;
- h. përdorimit të alkoolit nen ndikimin e tij ose ne gjendje te dehur, përdorimit të drogës apo substancave halucinative apo abuzimit me substanca kimike (ilacë ose droga);
- i. pérkeqësimet e shëndetit për shkak të trajtimeve mjekësore, terapive, injeksioneve, ndërhyrjeve kirurgjikale, kurimit apo kontrolleve për pasoja që nuk janë shkaktuar nga aksidentet;
- j. vetëvrasjes ose tentativës për vetëvrasje ose akteve të kryera me dashje apo të tentuara nga i siguruari edhe nëse personi nuk është i përgjegjshëm në momentin e ndodhjes së aktit;
- k. dëmtimeve të shkaktuara vetëvetes edhe nëse personi nuk është i përgjegjshëm në momentin e ndodhjes së aktit;
- l. ekspozimit ndaj të gjitha llojeve të radiacionit pavarësisht nga origjina e shkaktimit të tyre;
- m. aksidenteve apo sëmundjeve të ndodhura/shkaktuara përpara datës së fillimit të mbulimit në sigurim;
- n. ndikimit të problemeve mendore apo çdo lloj defekti fizik apo mendor i të siguruarit që nuk është shkaktuar nga aksidenti gjatë periudhës së siguruar;
- o. Sindromës së Deficiencës Imunitare të Fituar (AIDS) dhe gjendjeve shëndetësore të lidhura me të;
- p. gjellitjes, thithjes apo injektimeve të vullnetshme të substancave farmaceutike, kimike, apo drogave pa autorizim nga mjeku;
- q. pjesëmarrjes së të Siguruarit në zënka dhe grindje; përfshirjes ose tentativës së kryerjes nga ana e të siguruarit në aktivitete të paligjshme, kriminale apo keqbërëse;
- r. përdorimit të lëndëve eksplozive dhe korodive, përveç rasteve kur është në përmbushje të detyrës profesionale;
- s. aksidenteve te ndodhura tek punonjësit si pasojë e mos zbatimit të rregullave të sigurimit teknik.

IV. PËRFITIMET

Përfitimet nga ky sigurim përcaktohen në policë dhe ose në shtojcat e saj

1. Përfitimi në rast humbje jete – Nëse gjatë periudhës që kjo Policë eshtë në fuqi, i Siguruarit pëson Dëmtim Trupor Aksidental me pasojë humbjen e jetës, Siguruesi me marrjen dhe miratimin e provave të nevojshme do t'i paguajë Përfituesit vlerën e përfitimit të barabartë me 100% të shumës së sigurimit të përcaktuar në Policën e Sigurimit.

2. Përfitimi në rast paaftësie të përhershme – Nëse gjatë periudhës që kjo Policë është në fuqi, i Siguruarit pëson Dëmtim Trupor Aksidental me pasojë Paaftësinë e Përhershme të plotë ose të pjesshme të përshkruara në Tabelën e Përfitimeve, atëherë Siguruesi, me marrjen dhe miratimin e provave të nevojshme, do t'i paguajë shumën përkatëse të përfitimit sipas Tabelës së Përfitimeve.

Sigurimi në Grup i Punonjësve nga Aksidentet Personale

Në rast të paaftësisë së përhershme jo të treguar në tabelë, perfitimi përcaktohet duke patur parasysh shkallën e humbjes së aftësive normale fizike dhe mendore të të Siguruarit, pavarësisht nga profesioni i tij.

3. Përfitimi në rast paaftësie të përkohshme – Nëse gjatë periudhës që kjo Policë është në fuqi, i Siguruari pëson Dëmtim Trupor Aksidental me pasojë Paaftësinë e përkohshme, Siguruesi me marrjen dhe miratimin e provave të nevojshme, do të paguajë një përfitim të llogaritur mbi bazën e vlerës së shpërbimit ditor të përcaktuar në Policën e Sigurimit dhe ditët e paaftësisë së përkohshme.

Përfitimi për paaftësi të përkohshme llogaritet për një periudhë maksimale prej 180 ditë pune dhe përfshihet në vlerën e përfitimit që do të llogaritet në rast vdekje apo paaftësi e përhershme.

Përfitimi për paaftësi të përkohshme do të paguhet i plotë nëse i Siguruari nuk mund të ushtrojë plotësisht veprimtarinë profesionale të treguar në Policën e Sigurimit ose 50% në rast se i Siguruari mund të ushtrojë pjesërisht veprimtarinë profesionale të treguar në Policën e Sigurimit.

Vlerat e paguara per paaftesi te perkohshme apo te perhereshme, do te inkuadrohen ne vleren e perfitimit ne rast humbje jete.

V. Mbulimi i shpenzimeve mjekesore ne rast aksidenti

- Nese gjate periudhes që kjo Policë është në fuqi, i Siguruari peson demtim trupor aksidental, Siguruesi do te paguaje/rimbursoje shpenzimet mjekesore te justifikuara me faturat tatimore te leshuara sipas legjislacionit ne fuqi nga ofruesit e sherbimeve mjekesore qe jane pjese e rrjetit mjekosor SIGAL;

Siguruesi paguan/rimburson shpenzimet mjekesore deri ne vleren e limitit vjetor të percaktuar ne formularin e policës së sigurimit per kete mbulim dhe për të cilën ky sigurim është i vlefshëm, si rrjedhoje e pageses se primit shtese per kete mbulim.

Siguruesi do te paguaje/rimbursoje shpenzimet për sherbime mjekesore të cilat njihet se kanë aftësi diagnostikuese, stabilizuese apo përmiresuese dhe të cilat janë të nevojshme nga ana mjekësore, sipas rekomandimeve te mjekut; Ketu do te perfshihen edhe shpenzimet per medikamente/ilace qe kategorizohen te tilla ne baze te principit aktiv.

VI. PROCEDURA PËR KËRKESA PËR PAGESË

1. Njoftimi i ngjarjes së Sigurimit – Çdo ngjarje ose dëmtim që mund të çojë në një kërkesë për pagesë/përfitim sipas kësaj police, duhet ti njoftohet me shkrim SIGURUESI brenda 30 ditësh nga ndodhja. Mosnjoftimi brenda periudhës kohore të parashikuar më sipër e bën te pavlefshme kërkesën me përjashtim të rasteve kur provohet se nuk ka qenë e mundur dhënia e njoftimit dhe se njoftimi është dhënë sa po ka qenë mundësuar në mënyrë të arsyeshme.

I Siguruari ose Kontraktuesi duhet sa më shpejt që të jetë e mundur të kontaktojë një mjek të kualifikuar për të marrë kujdesin e duhur mjekësor, të ndjekë këshillat dhe rekomandimet e mjekut dhe ato të Siguruesit si dhe duhet të bëjë përpjekje maksimale për të minimizuar pasojat e aksidentit.

2. Kërkesa për pagesë - I Siguruari ose Përfituesi paraqet kërkesën për pagesë së cilës duhet ti bashkëngjiten të gjithë dokumentat e nevojshme që vërtetojnë Rastin e Sigurimit, pasojat dhe dëmtimet në aksident.

I Siguruari ose Përfituesi duhet të paraqesë në çdo rast dhe jo më vonë se 30 ditë nga lëshimi i tyre, dokumentat mjekesore, certifikatat mjekësore apo çdo lloj dokumentacioni tjetër që lidhet me aksidentin e që do t'i kërkohet nga Siguruesi. Shpenzimet për marrjen e dërgimin e dokumentave mbulohen nga i Siguruari.

SIGURUESI paguan përfitim për pasojat e drejtpërdrejta dhe ekskluzive të shkaktuara nga aksidenti i ndodhur brenda periudhës së sigurimit.

SIGURUESI do të ketë të drejtë por jo detyrim, që me shpenzimet e tij t'i kërkojë të Siguruarit të kryejë kontolle mjekësore gjatë shqyrtimit të kërkesës përfitim.

3. Pagesa e përfitimit – I sigururi nëpërmjet kesaj kontrate autorizon Kontraktuesin/Policëmbajtësin (punëdhënësin) si përfaqësuesin ligjor ne marëdhënie me siguruesin dhe çdo shumë e pagueshme sipas kësaj Police te siguruarit do të paguhet në përputhje me udhëzimet e Kontraktuesit. I siguruarit përfiton deri në limitin maksimal të shumës të sigurimit dhe vlera e përfitimit ne rastin e paaftësise se perhereshme perllogaritet sipas formules “shkallë e humbjes të aftësisë e shprehur ne (%)” shumëzuar me “shumën e siguruar”.

Sigurimi në Grup i Punonjësve nga Aksidentet Personale

Nëse kryhen kërkesa për përfitim që janë mashtruese në ndonjë aspekt, ose Kontraktuesi apo i Siguruari apo përfaqjësues që veprojnë në emër e për llogari të tyre përdorin mjete ose metoda mashtrimi për të përfituar pagesa sipas kësaj Police, atëherë SIGURUESI nuk do të ketë përgjegjësi për pagesën e këtyre kërkesave.

VII. PARASHIKIME TË TJERA

Fillimi dhe Përfundimi i mbulimit me sigurim – Kjo policë hyn në fuqi ne ores 24.00 te dites te shënuar në Policën e Sigurimit si datë e fillimit të periudhës së sigurimit dhe mbaron ne oren 24.00 te ditës te fundit te percaktuar si date e perfundimit te kontrates. Kjo Policë do të mbulojë automatikisht në sigurim të gjithë punonjësit e rinx të Kontraktuesit nga data e fillimit të punësimit, vetëm pas njoftimit që i bën Kontraktuesi Siguruesit menjehere pas fillimit te punesimit.

Mbulimi në sigurim për të Siguruarin do të përfundojë me ndodhjen e më të hershmes të njërsë prej ngjarjeve të mëposhtme:

- Përfundon periudha e sigurimit në datën e treguar në policë;
- Data në të cilën i Siguruarit përfundon mardhënien e punës me Kontraktuesin;
- Pas pagesës së përfitimit maksimal.

Pagesa e Primit të Sigurimit – Primi i sigurimit paguhet i plotë ose me këste, sipas datave të përcaktuara në Policën e sigurimit. Në qofte se primi i sigurimit ose kësti i parë i tij nuk paguhet në datën e lëshimit te polices sigurimit, sigurimi pezullohet deri ne oren 24 te ditës që kontraktuesi paguan shumen që detyrohet. Nga dita e lëshimit te polices sigurimit deri ne ditën e pagesës të primit të sigurimit, polica e sigurimit mbetet pa efekte juridike për palët dhe nuk krijon të drejtë dhe detyrime për to.

Kur kontraktuesi nuk paguan primet në vazhdim sipas afateve të caktuara, sigurimi pezullohet nga ora 24 e pas mbarimit të afatit të pagimit dhe siguruesi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës.

Gjate periudhes së mësipërme, Siguruesi ka të drejtën të deklarojë me leter rekomande ose postë elektronike zgjidhjen e kontratës.

Kufijtë gjeografikë – Mbulimi i dhënë nga kjo policë është i vlefshëm brenda kufijve territorialë të Republikës së Shqipërisë. Siguruesi dhe Kontraktuesi mund të bien dakord që të zgjerojnë kufirin gjeografik të mbulimit, duke nënshkruar një aneks shtesë.

Anullimi i polices së sigurimit - Siguruesi ka të drejtë të zgjidhë Policën e Sigurimit për shkak të njoftimeve e deklarimeve të pasakta të kryera me qëllim nga i Siguruarit ose Policëmbajtësi. Në këtë rast Policëmbajtësi ka të drejtën e pjesës së primit për periudhën e mbetur, duke zbritur shpenzimet administrative.

SIGURUESI ka të drejtë të zgjidhë Policën e Sigurimit në rast se Policëmbajtësi nuk paguan primin ose këstin e tij në përputhje me afatet e përcaktuara në policë.

Policëmbajtësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e Polices së Sigurimit në rast se i Siguruarit vdes për shkak të rreziqeve që nuk mbulohen nga Kushtet e Sigurimit. Në këtë rast Policëmbajtësi ka të drejtën e pjesës së primit për periudhën e mbetur, duke zbritur shpenzimet administrative.

Juridikzioni - Çdo kundërshti mbi këtë Policë që nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim reciprok është juridikson i legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ku është lëshuar polica e sigurimit.

Përbushja e parashikimeve të polices- Mospërbushja e parashikimeve të kësaj Police do t'i bëjë të pavlefshme kërkeshat përfitimi.

Korrespondenca - Korrespondenca midis Siguruesit dhe Kontraktuesit do të zhvillohen me shkrim.

Ndryshime te kushteve te kontrates - Çdo ndryshim i mundshëm i kushteve të kontratës duhet të miratohet me shkrim nga i Siguruarit dhe Siguruesi. Në respekt të **nenit 686 te Kodit Civil** i siguruarit deklaron se kushtet e per gjithshme dhe pjesa e kufizimeve apo perjashtimeve nga sigurimi të kësaj kontrate sigurimi nënshkruar me shoqerinë SIGURUESE SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a janë të **njohura dhe pranuara prej nesh**. Këto terma i kemi negociuar dhe pranuar me vullnet te plete e te lirë pasi jemi konsultuar me dispozitat ligjore në fuqi.

Policëmbajtësi /Përfituesi bie dakort që në rast mosmarrveshje ndërmjet tij dhe Siguruesit të ndërmjetësojë dhe ta zgjidhë sipas rregullave të procedurës të brendëshme të zgjidhjes jashtëgjyqesore të

Sigurimi në Grup i Punonjësve nga Aksidentet Personale

mosmarrëveshjeve. Për këtë qëllim është informuar mbi rregullat e brëndshme të shoqërise për mbrotjen konsumatore.

VIII. E Drejta e Zevendesimit

Ne rast kerkese per pagesen e perfitimit, Siguruesi duhet të njoftohet nëse i siguruari mbulohet nga një policë tjetër sigurimi. Në këto raste, SIGURUESI do të bashkërendojë pagesën dhe nuk do të jetë përgjegjës për më shumë se pjesën që i takon proporcionalisht. Nëse kërkesa për pagesen e perfitimit mbulohet plotësisht apo pjesërisht nga një program i financuar nga një institucion publik, atëherë SIGURUESI nuk do të jetë përgjegjës për pjesën e mbuluar. Policëmbajtësi dhe i siguruari zotohen të bashkëpunojnë me SIGURUESIN dhe ta lajmërojnë menjëherë mbi çdo kërkësë apo të drejtë veprimi ndaj paleve të treta. Nese demtimi aksidental eshte shkaktuar nga një pale e trete per gjegjese, siguruesi per cdo dem te paguar ze vendim e te siguruarit/përfituesit per te kerkuar kthimin e shumes te paguar nga personi per gjegjese për shkaktimin e dëmit. Në çdo rast, Siguruesi do të ketë të drejta të plota të subrogimit. Pagesa e përfitimit do të jetë në varësi të kalimit tek Siguruesi i të gjitha të drejtave të Policëmbajtësit/Përfituesit/të siguruarit ndaj çdo pale të tretë përgjegjëse për ngjarjen e sigurimit, dhe asnjë person ose autoritet nuk do të veprojë për të paragjykuar këto të drejta.

Çdo kërkues pagese sipas kësaj police, me kërkësën e SIGURUESIT, do të ndërmarrë dhe do të lejojë të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për ushtrimin e të drejtave ndaj çdo pale të tretë në emër të të Siguruarit para dhe/ose pas çdo pagese të kryer nga SIGURUESI.

IX. MBROJTJA E TE DHENAVE PERSONALE

I siguruari është njohur me deklaratën e privatesise të shoqerisë së Sigurimeve dhe autorizon Siguruesi që të mbledhë dhe përpunojë të dhënrat dhe informacionin personal i cili nevojitet për administrimin e kontratës së sigurimit, për dhëni e shembimeve ndaj të siguruarit dhe përfituesit përfshirë trajtimin e dëmit, për ofrimin e produkteve apo shërbimeve të reja, bazuar në ligjet përkatese në fuqi (Ligji Nr. 9887, date 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale") si dhe transferimin e të dhenave personale tek te tretë për qëllime të sigurimit apo biznesi të cilët garantojnë gjithashtu mbrojtjen e të dhënave personale. Ne cdo rast, mbrojtja e të dhenave personale do te behet ne perputhje me rregullat dhe procedurat e percaktuara ne Ligjin Nr. 9887, date 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

X. E DREJTA E INFORMIMIT

- I siguruari ka te drejten te informohet nga Siguruesi mbi kushtet, procedurat dhe afatet e mbulimit dhe/ose perfitimit nga sigurimi, informim i cili fillon para nënshkrimit të kontratës dhe vazhdon gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës. Informimi merret nepermjet telefonit, e-mailit, faqes zyrtare ne internet apo broshurave informative te perdoruara nga shoqeria dhe ne Departamentin e Shendetit dhe Aksidenteve ne adresen e email infoshendet@sigal.com.al.

- I siguruari dhe/ose Policëmbajtësi jane informuar nga Siguruesi përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit, duke marre te gjithe informacionin e nevojshëm në lidhje me te dhenat juridike te siguruesit, llojin përkatës të sigurimit, procedurat, afatet, metodat e trajtimit te kerkësave per demshperblim, rreziqet e mbuluara dhe te perjashtuara, metodat e llogaritjes, afatet dhe menyra e pageses se primit, metoden e llogaritjes se vleres se kompueshme dhe cdo informacion tjeter qe ka lidhje me kontraten e sigurimit.

XI. E DREJTA E TE SIGURUARIT PER T'U ANKUAR

I siguruari apo persona të tjerë të interesuar, kane te drejte të paraqesin një ankesë pranë shoqërisë së sigurimit, ne rast se cmojne se shoqeria e sigurimit nuk u përbahet kushteve të vendosura në kontratën e sigurimit apo procedures dhe masës te perfitimit. Ankesa mund te paraqitet ne forme elektronike (e-mail) ne adresen infoshendet@sigal.com.al ose me shkrim ne adresen postare te shoqerise Bulevardi Zog I-re Nr.1 Tirane Shqiperi Kutia Postare Nr.2387. Shoqëria e sigurimit do ti perggjigjet çdo ankesë të depozituar me shkrim apo në formë elektronike dhe do te jep çdo informacion të kërkuar që ka lidhje me kontratën e sigurimit, brenda afateve te percaktuara ne ligj dhe kontraten e sigurimit.

Sigurimi në Grup i Punonjësve nga Aksidentet Personale

Kjo kontratë sigurimi hartohet dhe zbatohet në përputhje me kushtet e percaktuara si më siper, Kodin Civil, Ligjin nr.52 te vitit 2014 "Për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve"

NENSHKRIMET E PALEVE NE POLICEN/FORMULARIN E SIGURIMIT VERTETOJNE SE KANE RENE DAKORT ME INFORMACIONIN E DHENE PARAPRAKISHT, KANE LEXUAR DHE KUPTUAR TE GJITHA TERMAT DHE KUSHTET E KESAJ KONTRATE SIGURIMI, DHE PRANOJNE ME VULLNET TE LIRE T'I RESPEKTOJNE ZBATOJNE ATO. KETO KUSHTE JANE NJOHUR DHE PRANUAR PER TU RESPEKTUAR DHE ZBATUAR NGA PERFITUESI I KESAJ KONTRATE I CILI ESHTE DHE MBAJTES I KONTRATES.

Tabela e Përfitimeve pjese perberese e Kontrates Sigurimit

Përfitimi i pagueshmë në përqindje ndaj Shumës së Sigurimit të përcaktuar në Formular

Humbja

A Humbja e jetës

100%

B Paafësi e Përherershme		
1 Paafësi e Plotë e Përherershme		100%
2 Humbje ose humbje e plotë e përherershme e përdorimit të dy gjymtyrëve		100%
3 Humbje ose humbje e plotë e përherershme e përdorimit të një gjymtyre		75%
4 Humbje e plotë e përherershme e shikimit në të dy sytë		100%
5 Humbje e plotë e përherershme e shikimit në një sy		75%
6 Humbje ose humbje e plotë e përdorimit të një gjymtyre dhe humbja e shikimit në një sy		100%
7 Humbje e të folurës dhe dëgjimit		100%
8 Humbje e përherershme dhe e pakurueshme e shëndetit mendor		100%
9 Humbje e plotë e përherershme e dëgjimit		
a) në të dy veshët		70%
b) në një vesh		20%
10 Humbje e plotë e të folurës		70%
11 Humbje ose humbje e plotë e përherershme e përdorimit të pesë gishtërinjve të dorës		
a) të djathë		50%
b) të majtë		30%
12 Humbje ose humbje e plotë e përherershme e përdorimit të katër gishtërinjve të dorës		
a) të djathë		30%
b) të majtë		15%
13 Humbje ose humbje e plotë e përherershme e përdorimit të gishtit të madh të dorës		
a) të dyja falangat e gishtit të djathë		30%
b) një falangë e gishtit të djathë		15%
c) të dyja falangat e gishtit të majtë		20%
d) një falangë e gishtit të majtë		10%
14 Humbje ose humbje e plotë e përherershme e përdorimit të gishtërinjve të tjere		
a) tre falanga të një gishti të dorës së djathë		10%
b) dy falanga të një gishti të dorës së djathë		7%
c) një falange e një gishti të dorës së djathë		5%
d) tre falanga të një gishti të dorës së majtë		7%
e) dy falanga të një gishti të dorës së majtë		5%
f) një falange e një gishti të dorës së majtë		3%
15 Humbje ose humbje e plotë e përherershme e përdorimit të gishtërinjve të këmbës		
a) të gjithë gishtërinjtë e një këmbe		10%
b) dy falanga të gishtit të madh të këmbës		5%
c) një falangë e gishtit të madh të këmbës		3%
d) seicili prej gishtave përvëç gishtit të madh		1%
16 Shkurtim i këmbës me të paktën 5 cm		7%
17 Djegje të shkallës së tretë		

Sigurimi në Grup i Punonjësve nga Aksidentet Personale

Zona:	Dëmtimi si përqindje e Sipërsfares së Përgjithshme të Trupit	
- koka	e barabartë ose më e madhe se 2% por më pak se 5%	25%
	e barabartë ose më e madhe se 5% por më pak se 8%	40%
	e barabartë ose më e madhe se 8%	100%
- trupi	e barabartë ose më e madhe se 10% por më pak se 15%	25%
	e barabartë ose më e madhe se 15% por më pak se 20%	40%
	e barabartë ose më e madhe se 20%	100%

Kushte të veçanta:

1. Përfitimi i përgjithshëm i pagueshëm në lidhje me paaftësitet që janë rrjedhojë e të njëjtit dërmtim llogaritet duke mbledhur përqindjet e tyre por nuk do të kalojë 100% të shumës së sigurimit dhe Siguruesi nuk do të jetë më përgjegjës sipas kësaj Police për të njëtin të Siguruar për Dëmtime Trupore Aksidentale.

2. Në rastet kur i Siguruari është mëngjérash, përqindjet e përfitimeve të pikave 11 deri 14 më sipër do të këmbehen duke pasur parasysh se përqindja më e lartë e përfitimit do të zbatohet për dorën e majtë dhe pjesët e saj.